

Njoftim i përqendrimit me të cilin SMURFIT KAPA GRUP PLC, Irlandë do të fitoj kontrollin e VestRok Kompani, SHBA

(lënda nr. 08-167/2023

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ Nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 21.11.2023 dhe plotësuar më 06.12.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin SMURFIT KAPA GRUP PLC, me seli në Biç Hill, Klonskig, Dablin 4, Irlandë do të fitojë kontrollin e VestRok Kompani, me adresë në 1000 Abernati Roud, NE Atlanta, GA 30328, SHBA. Gjegjësisht, në përputhje me kushtet e marrëveshjes së transaksionit të 12 shtatorit 2023, ndër të tjera, Kompania Holding Irlandeze e sapo themeluar (e njohur si Smurfit VestRok Plc (*Smurfit WestRock plc*)) do të blejë të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të SMURFIT KAPA GRUP PLC përmes një skeme marrëveshjeje sipas nenit 450 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 2014 të Irlandës, dhe Ndërmarrja-bijë amerikane e grupit të kombinuar Smurfit VestRok ("Merxher Sab") do të bashkohet me dhe në VestRok Kompani, pas së cilës ekzistenca e veçantë e korporatës e Merxher Sab do të pushojë, dhe VestRok Kompani do të vazhdojë si një korporatë që vazhdon të ekzistojë në mënyrë që pas këtij bashkimi, korporata që vazhdon të ekzistojë do të jetë një kompani e plotë në pronësi të Smurf WestRock.korporata që vazhdon të ekzistojë do të jetë një Ndërmarrje-vajzë në pronësi të plotë të Smurfit VestRok.

Pas transaksionit të propozuar, aksionarët e SMURFIT KAPA GRUP PLC dhe aksionarët e VestRok Kompani pritet të zotërojnë afërsisht 50.4% dhe 49.6% të grupit të kombinuar, Smurfit VestRok, bazuar në numrin e aksioneve të të dy ndërmarrjeve nga data e publikimit të Transaksionit të Propozuar.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

SMURFIT KAPA GRUP PLC, Shoqëria FTSE 100 dhe shoqëria mëmë e Smurfit Kapa Grup (Smurfit Kappa Group) është një nga ofruesit kryesorë në botë të zgjidhjeve të paketimit me bazë letre, me më shumë se 47,000 punonjës në mbi 350 lokacione prodhimi në 36 vende dhe të ardhura prej 12.8 miliardë euro në 2022. SMURFIT KAPA GRUP PLC ndodhet në 22 vende në Evropë, 13 në Amerikë dhe një në Afrikë. SMURFIT KAPA GRUP PLC është i vetmi lojtar pan-rajonar në shkallë të gjerë në Amerikën Latine. Produktet e saj, të cilat janë 100% të rinovueshme dhe të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme, përmirësojnë ndikimin mjedisor të klientëve të saj.

SMURFIT KAPA GRUP PLC nuk ka ndërmarrje-bijë, degë ose përfaqësime të vendosura në Maqedoninë e Veriut.

VestRok Kompani, një shoqëri publike me seli në SHBA, është një ofrues shumëkombësh i zgjidhjeve inovative, të qëndrueshme të letrës dhe paketimit, kryesisht aktive në SHBA, por që operon gjithashtu në Evropë, Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut, Azi dhe Australi.

Kompania VestRok është aktive në prodhimin dhe furnizimin e ambalazheve prej kartoni, kartonëve të palosshme, kontejnerëve të kartonit dhe produkteve të ambalazhimit të ndryshëm, midis produkteve dhe shërbimeve të tjera. Në BE, VestRok Kompani është e fokusuar në shitjen e kartonëve të palosshme, etiketave, fletëpalosjeve, kartonit, kanoçeve të përbëra dhe makinerive të paketimit.

Kompania VestRok nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut, as nuk ka Ndërmarrje-bijë, degë apo përfaqësi në Maqedoninë e Veriut.

Transaksioni i propozuar i referohet tregut të paketimit të kartonit të palosshëm/ paketim me kuti kartoni për montim.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

12.12.2023

Shkup